



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, si gjykatë lëndore e shkallës së parë, gjyqtari Misin Frangu, me procesmbajtësen Ibadete Qerimi, në çështjen juridike të paditësit [REDACTED] nga Ferizaj rr. [REDACTED], të cilin e përfaqëson me autorizim avokati [REDACTED] nga Ferizaj, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim [REDACTED] juriste nga Prishtina, në çështjen kontestimore shpërblim i dëmit material dhe jo material, pas shqyrtimit kryesor dhe publik të mbajtur me datë 07.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET, pjesërisht si e bazuar kërkespacia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj rr. [REDACTED], dhe **DETYROHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, që paditësit për dëmin e pësuar në aksidentin e datës 24.12.2014, në emër të zhdëmtimit të dëmit jomaterial dhe material ti paguan shumën e tërësishme prej 2000 €, të gjitha me kamat 8% duke llogaritur nga dita e nxerrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën përfundimtare, nën kanosjen e përmbartimit të dhunshëm.

Kompenzimi i dëmit jo material:

- Dhembje të intenzitetit të lartë shumën prej300 €
- Dhembje të intenzitetit të mesëm100 €
- Dhembje të intenzitetit të ulët300 €
- Për frikë sekondare të intenzitetit të lartë500 €
- Frikë sekondare të intenzitetit mesatar350 €
- Frikë sekondare të intenzitetit të ulët320 €

Gjithësej dëmi material dhe jomaterial është.....1870 €

II. DETYROHET, e paditura ti kompenzoj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: Për përpilimin e padisë shumën prej 104 €, përfaqësimin për katër seanca shumën prej 405 €, për dy ekspertizat mjeksore shumën prej 200 €, dhe për taksën gjyqore Shumen prej 50 € apo gjithësej shumën prej 759 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET, kërkespacia për shumën prej 420 €, sa i përket dëmit jo material dhe material si e pa bazuar.

Arsyetim

Paditësi [REDAKTUAR] nga Ferizaj, përmes përfaqësuesit të tij avokat [REDAKTUAR] nga Ferizaj, në padi dhe kërkespadi dhe në fjalën përfundimtare ka konfirmuar se mbetet në tërësi pranë padis dhe kërkespadis nga fakti se baza juridike e kërkesëpadisë vërtetohet nga provat e shtjelluara në seancat gjyqësore se paditësi [REDAKTUAR], i është shkaktuar dëm si pasojë e aksidentit të shkaktuar me dt.24.12.2014.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve ka deklaruar se nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, pasi të njëjtit ju është dhënë oferta në procedurën administrative po ashtu është bazuar edhe në raportin policor, është konstatuar se shkaktar i aksidentit është [REDAKTUAR], andaj me qëllim të ekonomizimit të procedurës është bërë vlerësimi mjekësor nga mjekët cenzor të kompanisë dhe për të njëjtën është konstatuar se ka pësuar lëndime të lehta trupore i ofrojmë shumën prej 650 €.

Në seancën e datës 09.12.2016, përfaqësuesi i paditësit kishte mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkespadisë dhe ka rezervuar të drejtën që pas ekzaminimit të ekspertëve mjekësor të parashtojë pyetje dhe pastaj të përpiloj precizimin e kërkespadis në bazë të kriterëve të cilat do ti vlersojnë ekspertët.

Përfaqësuesi i të paditurës [REDAKTUAR] ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë thënjeve në seancën e sodit dhe të mëhershme.

Andaj gjykata kishte aprovuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit dhe kishte vendosur që të ekzaminohet paditësi nga ana e ekspertit mjekësor psikiatër Dr. [REDAKTUAR] më datë 07.03.2017, i cila sipas saj paditësi kishte përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë e manifestuar si gjendje akute në stres e përcjellë me shqetësime dhe konfuzitet e që ka zgjatur njëzet e katër orë, paditësi ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit mesatar për tri javë dhe që nënkupton reperkusion fizikë dhe psikik që gjendja të përballohet dhe të përmirësohet, paditësi ka përjetuar frikë sekondare të shkallës së ultë edhe për tre muaj të manifestuar me ankth, frikë, çrregullime të rritjes së gjumit, zgjimit të shpeshtë gjatë natës, ankesa të shumta somatike si dhe reduktim të aktivitetit dhe raporteve shoqërore, për të cilat ka prezentuar raport specialistik psikiatrik nga qendra për shërim mendor në Ferizaj.

Paditësi ishte ekzaminuar edhe nga Dr. [REDAKTUAR] ortoped-traumatolog i cili sipas këtij eksperti kishte pësuar përdredhje të qafës, ka përjetuar dhembje të muskujve të shpinës, i njejt ka pasur nevojë për shërim me terapi fizikale, lëndimet e sipërpërmendura paraqesin lëndime të lehta trupore, si pasojë e këtij aksidenti, i dëmtuari ka përjetuar dhembje të intensitetit të lartë 12 orë, dhembje të intensitetit të mesëm i dëmtuari ka përjetuar 10 ditë dhimbje të intensitetit të ultë të i dëmtuari kanë zgjatur dy javë.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë nxjerrjen e provave: si Raporti i Qendrës Emergjente në Ferizaj me nr.668 i dt. 24.12.2014, Raporti i Policisë me nr.2014-CF-2849 i dt.24.12.2014, udhëzimi për konsultim i dt.20.01.2015, raporti nga konsulta i dt. 20.01.2015, raporti nga konsulta i dt.04.02.2015, raporti nga konsulta i dt.18.02.2016, Raporti nga konsulta i dt.26.01.2015, udhëzimi për hulumtime diagnostike i dt.08.01.2015, Raporti nga konsulta i dt.14.01.2015, Raporti nga konsulta i dt.11.02.2015.



Raporti Specialistik nga Shërbimi Ambulator Toni i dt.21.02.2015, Raporti specialistik klinika Ortopedike "Gjenezis" i dt.05.01.2015, Raporti Specialistik Klinika Ortopedike "Gjenezis" i dt.09.01.2015, raporti Specialistik Klinika Ortopedike "Gjenezis" i dt 14.01.2015, Raporti Specialistik Klinika Ortopedike "Gjenezis" i dt .25.12.2014, edhe kuponat fiskal të marra nga Oridinacat e cekura me lart me numër 10. Ekspertizat mjeko-ligjore e punuar nga Dr. [REDACTED] e dt 09.01.2017.

I autorizuari i paditësit avakati [REDACTED] në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke shtuar se nga provat e administruara u vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë e të cilën as përfaqësuesi i të paditurës nuk e ka kontestuar, ka konsideruar se në bazë të lëndimeve të pësura të paditësit shuma e kërkuar prej 2290.00 €, është vlerësim real, dhe ka kërkuar nga ana e gjykatës që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës të precizuara në parashtrësën e precizimit të kërkesëpadisë.

I autorizuari i të paditurës [REDACTED] në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim tha se nuk e kontestojmë bazën juridike të kërkesëpadisë por vetëm lartësin e saj, pasi që e njëjta është tejte e lartë duke e marre parasysh natyrën e lëndimeve, andaj duke pasur parasysh këtë rrethanë nëpërmjet kësaj parashtrëse ofrojmë shumat për kompenzimin e dëmit ashtu si i kemi prezentuar në seancat e kaluara oferta në lartësi prej 650 €, e cila konsiderojmë se është adekuate për këtë dëm.

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimin të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Me leximin e raportit të aksidentit të ndodhur me datë 24.12.2014, gjykata konstatoi se deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur me fajin e drejtuesit të veturës së automjetit të udhtarëve "Ford", ku lëndime të lehta trupore kishte pësuar paditësi [REDACTED].

Me leximin e Raportit të Spitalit Regjional të Ferizajt të datës: 24.12.2014, konstatohet se paditësi është sjellur për lëndimet e marra në aksidentin e dt.24.12.2014, e kjo vërtetohet edhe me raportet tjera mjeksore, të raporteve të ndryshme dhe ordinancave të ndryshme.

Me leximin e ekspertizës të ekspertit psikiatër Dr. [REDACTED] gjykata konstatoj se kjo ekspertizë në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe të ekzaminimit të drejtëpërdrejtë të paditësit ka konstatuar se paditësi në këtë aksident kishte pësuar frikën sekondare të intensitetit të lartë, frikën sekondare të intensitetit mesatar, paditësi ka përjetuar frikë sekondare të shkallës së ultë.

Me leximin e ekspertizës mjeksore të ekspertit ortoped-traumatolog Dr. [REDACTED], e marrur drejtëpërdrejtë në seancën e dt.14.02.2017 gjykata konstatoj se ky ekspert në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe të ekzaminimit të drejtëpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi në këtë aksident kishte përjetuar dhimbje të intensitetit të lartë, intensitetit të mesëm dhe të intensitetit të ultë. Nuk ka pasur shëmtim trupor, dhe bëhet fjalë për lëndime të lehta trupore.

Me leximin e raportit të policisë të dt.24.12.2014, dëshmohet se fajin kryesor, për aksidentin e shkaktuar e mban shoferi i veturës "Ford", të cilin e drejtonte [REDACTED].



Me shtjellimin dhe vlerësimin e provave gjykata e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike në këtë çështje juridike. Me vërtetimin e gjendjes faktike ka përfunduar se kërkespadija e paditësit është pjesërisht e bazuar. Këtë përfundim gjykata e bazon në provat dhe shkresat e lëndës, ku paditësi [REDAKTUAR] në aksidentin e dt.24.12.2014, kishte marrë lëndime të lehta trupore, me fajin e drejtuesit të automjetit të udhëtarëve të tipit "Ford" me tabela regjistrimi [REDAKTUAR] i cili automjet kishte qenë i siguruar me polis kufitare.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit ka vlerësuar edhe kundërshtimin e të autorizuarit të paditurës ku ka kërkuar nga ana e gjykatës të ketë parasysh edhe ofertën e ofruar nga ana e Byros Kosovare të Sigurimeve "BKS", lëndimet e pësuar të paditësit në komunikacion me lartësinë e dëmit të kërkuar dhe kërkespadijën e paditësit ta aprovon pjesërisht lidhur me natyrën e lëndimeve.

Por gjykata me rastin e vendosjes për shumat e gjykuara ka marrë për bazë edhe ekspertizën e ekspertit të psikiatris dhe ekspertit ortoped-traumatolog të cilët pas ekzaminimit të paditësit dhe dokumentacioneve mjekësor kanë konstatuar se paditësi nga ky aksident kishte marrë lëndime të lehta trupore, kishin përjetuar dhembje, frikë dhe pasoja tjera, pastaj dhimbje fizike të të gjitha llojeve ku të njejtat sipas vlerësimit të lirë iu ka përcaktuar kompenzimin e dëmit, ashtu si është përcaktuar më afër në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Me këtë përfundim gjykata vlerëson se shumat e gjykuara paditësit do ti shërbeje si një dëmshpërblim real për të gjitha ato që e ka përjetuar në këtë aksident të trafikut.

Gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar kërkespadijën e paditësit për shumat më të larta se ato të gjykuara me arsyetim se një kërkesë e tillë e paditësit nuk ka mbështetje në vlerësim real të dëmit jomaterial dhe për këtë ka vendosur si në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin për aprovimin e kërkespadiisë e bazoi në dispozitën ligjore neni 200, paragrafi 1, lidhur me nenin 185 të LMD-së, (i vjetër), përkatësisht në nenin 183, lidhur me nenin 173 LMD-së (i ri). Ndërsa lidhur me kompenzimin e dëmit jo material, gjykata vendimin e bazoi në nenin 323 të LPK-së.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërblimit të dëmit jo-material dhe material, paditësit ja ka njohur të drejtën në kamatë ligjore prej 8 %, prej datës 21.08.2015, deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së,

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në bazë të neneve 449 dhe 452.2 të LPK-së.

Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.480/15, dt.07.03.2017



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, për mënyrën e kësaj gjykate.

